

KUSHTET DHE AFATET

GARANCI PESË-VJEÇARE

1. Kjo garanci pesë-vjeçare ofrohet nga Samsung dhe është e vlefshme për pajisjet e blera në periudhën nga 15.2.2018. deri në 31.12.2018. dhe vetëm për blerjen e pajisjeve të montueshme inkaso (furra, pjanura dhe aspiratorë kuzhine, pjatararëse) të renditur në faqen e mëposhtme të internetit: www.samsung5vitegaranci.al
**Termi "të rinj" përfshin gjithashtu pajisjet e papërdorura të ekspozimit dhe pajisjeve në shitje.*
2. Për të ushtruar të drejtën e garancisë pesë-vjeçare, të gjitha detajet rreth pajisjes duhet të regjistrohen online në faqen e internetit: www.samsung5vitegaranci.al duke ndjekur udhëzimet e dhëna në këtë faqe.
3. Një pajisje për të cilën kërkohet garancia pesë-vjeçare duhet të regjistrohet online (siç tregohet më sipër në pikën 2) jo më vonë se 60 ditë nga data kur është lëshuar fatura e blerjes.
4. Pas regjistrimit, aplikanti do të marrë një email pas regjistrimit dhe një Letër Garancie për garancinë pesëvjeçare të zgjatur me numrin e serisë të pajisjes të regjistruar.
5. Letra e Garancisë për garancinë pesë-vjeçare duhet të ruhet gjatë të gjithë periudhës së garancisë.
6. Garancia pesë-vjeçare nuk mund të transferohet te asnjë pajisje tjetër Samsung, përveç asaj të regjistruar online.
7. Kjo ofertë është e vlefshme vetëm për përdoruesit e fundëm (individë), dhe jo për kompani ose organizata për qëllime rishitjesh ose përdorimi tregtar.
8. Duke e regjistruar pajisjen për garancinë pesë-vjeçare në mënyrën e lartpërmendur, përdoruesit janë dakord me këto Kushte dhe Afate.